

PJËSMARRJA NË SHKOLLËN VERORE TË ORGANIZUAR NË SHKUP, MAQEDONI

Quhemi Katerina dhe Vangjel, jemi studentë të vitit të dytë Financë- Kontabilitet, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë dhe sapo jemi kthyer nga Shkolla Verore Ndërdisciplinore Ndërkombëtare e organizuar në Universitetin e Shkupit, Maqedoni me temë “Ndryshimet klimatike dhe Siguria: Një çështje globale në kontekstin lokal”, e cila u mbajt gjatë periudhës 16-27 Tetor 2017.

Thirrjen për organizimin e kësaj veprimtarie e pamë të postuar në faqen zyrtare në facebook të Qendrës së Karrierës dhe Alumni Universiteti “Fan S. Noli” dhe menjëherë shkua të marrim informacion të mëtejshëm tek zyra. Aplikimin e kryem online duke dërguar në e-mailin e shpallur për këtë qëllim një CV dhe Letër Motivimi, ku shprehëm jo vetëm dëshirën për të marrë pjesë por dhe interesin profesional që kishim për këtë temë.

Shkolla verore kishte studentë pjesëmarrës nga Rajoni i Ballkanit dhe profesorë me tituj, të cilët na spjeguan me pasion çdo çështje që lidhej me temën e lartpërmendur si: detyrimet ligjore ndërkombëtare në lidhje me ndryshimin e klimës, hyrja në sigurinë mjedisore dhe efektet e ndryshimeve klimatike në disponueshmërinë e ujit për sektorin e bujqësisë në Siri, azili në të drejtën ndërkombëtare në bazë të Konventës së vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatit, emigrimi në Bashkimin Evropian si çështje gjeopolitike, etj.

Projekti mbuloi shpenzimet tona të udhëtimit dhe akomodimit. Të gjithë pjesëmarrësit ishin miqësorë dhe ndanë shumë eksperiencë profesionale me ne. Në fund të kësaj veprimtarie finalizuam një projekt në grup me temë “Jepni një pasqyrë të shkurtër mbi mënyrën se si vendi juaj (Shqipëria) merret me refugjatët. Korniza ligjore, çështjet politike/ ekonomike /sociale, debatet aktuale dhe problematikat”. Kjo shkollë verore u finalizua me dhënien e certifikatave për pjesëmarrjen në të.

Gjatë mbasditeve kishim të përfshirë në program edhe ekskursione, të cilat udhëhiqeshin nga një guidë maqedonase që njihnte mirë historinë e vendit, patëm mundësinë jo vetëm të njihnim qytetin e Shkupit por edhe kulturën të pjesëmarrësve të tjerë nga rajoni i ballkanit, si edhe të tregojmë për historinë dhe kulturën e vendit tonë.

Arsyeja pse vendosëm të shkruajmë këtë letër është të motivojmë bashkëmoshatarët tanë studentë, të aplikojnë sa më shumë në projekte që i shohin me interes dhe të

drejtohen pa hezitim pranë Qendrës së Karrierës dhe Alumni, për mundësi të ndryshme që egzistojnë. Ne besojmë se, nëse nisni diçka me dëshirë dhe vullnet gjithmonë do të keni shansin për të fituar. Mos humbisni asnjë mundësi, të cilat sot në epokën e internetit janë të lira dhe te prekshme lehtësisht, por guxoni sepse nga një dritare në dukje simbolike mund të hapet një derë karriere.

Me respekt

Katerina Bregu dhe Vangjel Palolli

